



Asociacioni i Komunave të Kosovës

R A P O R T

nga

Takimi i Kolegjiumit për Shërbime Publike

Prishtinë, 4 tetor 2011

Për: Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

Nga: Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve të AKK-së

Lënda: Raport nga takimi i Kolegjiumit për Shërbime Publike



HYRJE

Asociacioni Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Kryesinë e Kolegjiut për Shërbime Publike organizoi takimin e radhës të këtij Kolegjiut me 4 tetor 2011 (e martë) me fillim nga ora 11:00 në Restorantin „ Villa Gërmia” në Prishtinë.

Takimi kishte këtë rend të ditës:

- Diskutim mbi projekt-Ligjin për Ndërmarrjet Publike,
- Diskutim mbi projekt-Ligjin për Ujëra,
- Programi për Zbatimin e Strategjisë së Ngrohjes (PZSN) 2011-2014

Në këtë takim morën pjesë drejtorë të drejtorive të shërbimeve publike të Komunave të Kosovës, përfaqësues nga MZHE – sektori për strategji të energjisë, si dhe përfaqësues nga Asociacioni i Komunave të Kosovës. Takimi u kryesua nga Kryesuesi i Kolegjiut të drejtorëve për Shërbime Publike z. Agim Haziri.

PËRMBLEDHJE

Kryesuesi shpjegoi rëndësinë e Kolegjiut në kuadër të AKK-së si avokues në interes të komunave, dhe përmes punës së përbashkët me AKK-në është ngritur zëri rreth problemeve të përbashkëta komunale. Duke marrë parasysh se ka qenë kërkesë e vazhdueshme e Komunave në ndryshimin e këtij ligji i cili është i një rëndësie të veçantë dhe prek në mënyrë të drejtpërdrejtë ofrimin e shërbimeve për qytetarët nga komuna. Duke u ndërlidhur me çështjen në fjalë të pranishmit i informoj se AKK ka organizuar takimin e Kryesisë së Kolegjiut të drejtorëve për shërbime publike me qëllim specifik diskutimin e propozimeve për ndryshim të projektligjit për Ndërmarrjet Publike të punuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Gjatë takimit Kryesia ka punuar në evidentimin e pikave për ndryshim si dhe ka dhënë vërejtjet dhe argumentet për ndryshim të projektligjit.

Kryesuesi me këtë rast kërkoj nga të pranishmit që edhe ata të japin vërejtjet, dhe propozimet për ndryshim në mënyrë që të dalim me rekomandime sa më konkrete në mbrojtje të interesave komunale që të mund të paraqesim vërejtjet tona në takim me zyrtarë të MZHE për diskutim të këtij drafti.

- **Diskutim mbi projekt-Ligjin për Ndërmarrjet Publike**

Duke ju referuar pikës kryesore të debatit për ndryshimin e ligjit për Ndërmarrjet Publike anëtarët e Kolegjiut diskutuan rekomandimet kryesore të cilat kanë rezultuar nga takimet e rregullta që AKK-ja ka mbajtur me mekanizmat e saj ku janë veçuar këto pika me prioritet për diskutim:

1. Pronësia
2. Ushtrimi i të Drejtave të Aksionarit
3. Themelimi i Ndërmarrjeve të reja Publike
4. Zgjedhja e Drejtorëve të NP
5. Listat e Ndërmarrjeve Publike Lokale

Gjatë diskutimit pjesëmarrësit shprehën edhe një herë shqetësimin e tyre në ndikimin që ka ky ligj në ofrimin e shërbimeve për qytetarët në Komunitat e Kosovës. Sa i përket pronësisë së NP në Komunitat, shumica e ndërmarrjeve janë të themeluara dhe menaxhuar nga komunitat, andaj edhe shumica e aseteve janë të komunitave.

Sa i përket të drejtave të aksionarëve pjesëmarrësit dhanë pajtimin e tyre në rastet kur një komunitat është aksionar në një NP Lokale, të drejtat e saj të aksionarit do të ushtrohet nga një Komision Komunal i Aksionarëve. Komisioni Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të Komunitatës përkatëse dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Anëtarët e komisionit të Aksionarëve duhet të kompensohen, pagesa për kompensim duhet të bëhet nga buxheti komunal.

Duke u ndërlidhur me temën e themelimit të NP, të gjithë u pajtuan që me vendim të qeverisë të themelohen Ndërmarrjet Publike Qendrore, ndërsa me vendim të komunitatës themelohen Ndërmarrjet Publike Lokale, në ofrimin e shërbimeve sa më të mira për qytetarët nga autoritetet lokale. Të gjithë pjesëmarrësit kërkuan që themelimi i NP Lokale të bëhet me vendim të Kuvendeve Komunale. Kolegjiumi kundërshton marrjen e miratimit qeveritar për themelimin e NP Lokale, sepse në të kaluarën Komunitata e Klinës dhe Istogut kanë bërë kërkesa të tilla por ende nuk kanë marrë një përgjigje nga Ministria.

Një vëmendje të veçantë duhet të ketë edhe në përcaktimin e kriterëve të qarta në organizimin e bashkëpunimit komunal sa i përket funksionimit të NP në komunitat e vogla për shkak të pamundësisë teknike dhe financiare. Sepse deri më tash ky bashkëpunim është treguar i pasuksesshëm dhe ka hasur në pengesa të pakapërcyeshme për shkakun e interesave të ndryshme të Kompanive Rajonale dhe vetë Komunitave.

Në të njëjtën vijë u kërkuar që të merret në konsideratë edhe themelimi i kompanive rajonale të ujit deri sa nuk është në kundërshtim me sistemin e përgjithshëm si dhe nuk bie ndesh me interesat qeveritare. Edhe pse drejtorët janë të vetëdijshëm se uji është një aset strategjik qeveritar, pjesëmarrësit shprehën opinionin e tyre që qeveria të jetë përgjegjëse për burimet dhe rrjedhjen e lumenjve deri tek rezervuarët e ujit, ndërsa komunitat të jenë përgjegjëse për rrjetin e shpërndarjes së ujit dhe arkëtimin e të hyrave për shkakun se komunitat janë investues direkt nga buxheti komunal në këtë rrjet.

Duke e marrë parasysh rëndësinë e diskutimit për ndryshim të LNP në takim përveç drejtorit ekzekutiv të AKK, pjesëmarrëse në takim ishte edhe zyrtarja nga ICO, duke shprehur interesim për të dëgjuar vërejtjet dhe rekomandimet nga dora e parë nga drejtorët komunal sa i përket propozim-ndryshimeve të ligjit për NP, ku së shpejti edhe do të dalin me rekomandimet e veta sa i përket këtij ligji.

Drejtorët edhe njëherë shprehën rëndësinë e këtij ligji në ofrimin e shërbimeve për qytetarët, si dhe dhanë vërejtjet dhe rekomandimet e tyre në zgjidhjet e mundshme në këtë fushë. Vërejtje serioze u shprehën sa i përket Kompanive Rajonale për shkak të menaxhimit të dobët dhe paaftësisë në zgjidhjen e problemeve në komunitat, mos përgjegjshmëria e tyre për punën, si dhe pamundësisë së komunitat të

kontribuojnë në punën e tyre në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët nga këto kompani përkundër investimeve të cilat kryen komuna.

Një ndër rastet e suksesshëm është themelimi i NP Lokale nga Kuvendi Komunal i Kaçanikut i cili deri tani ka rezultuar i suksesshëm në ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe inkasimin e të ardhurave për këto shërbime (deri 81% të hyrave).

Një kërkesë tjetër ishte edhe nevoja që ky ligj të mos kufizohet vetëm në themelimin e ndërmarrjeve të mbeturinave dhe ujit por të përfshij edhe sektorët tjerë të shërbimeve publike si ndriçimi i rrugëve, tregu i gjelbër, ngrohje dhe mirëmbajtje të rrugëve.

Njëra ndër arsytet thelbësore dhe argumentuese që paraqitën drejtorët janë edhe :

- Menaxhimi më i mirë i parasë publike,
- Kosto më e ulët për shërbimet ndaj qytetarëve,
- Efikasitet më i mirë në ofrimin e shërbimeve për qytetarët,
- Përgjegjësia në menaxhim dhe mirëmbajtje për shkak të investimeve nga komunat dhe investitorët dh donatorët e huaj.
- Themelimi i NP të reja në fushat e tjera të shërbimeve publike në ofrimin sa më të mirë të shërbimeve për qytetarët në sektorët tjerë sikurse ndriçimi i rrugëve, transporti lokal, tregu i gjelbër, ngrohje lokale, dhe mirëmbajtje të rrugëve, në ofrimin e shërbimeve për qytetarët.

Si konstatim i përgjithshëm i të gjithë drejtorëve është se nëse nuk merren parasysh këto vërejtje e sugjerime, të dala nga mekanizmat e AKK-së si organ i vetëm që përfaqëson komunat, atëherë do të vejë në hije praktikat e mira të bashkëpunimit të deritashëm mes komunave dhe qeverisë dhe do të lerë në pikëpyetje bashkëpunimin e ardhshëm në fushën e decentralizimit.

▪ **Diskutim mbi projekt-Ligjin për Ujëra**

Sa i përket diskutimit mbi projekt-Ligjin për ujëra, drejtorët shprehën mbështetjen e rekomandimeve të grupit punues i cili ka mbajtur takimet dhe paraqitjen e vërejtjeve dhe rekomandimeve që do të ndihmonin komunat në ushtrimin e kompetencave në menaxhimin e ujit. Kolegjiumi u pajtua në parim me vërejtjet dhe rekomandimet e dala nga këto takime dhe ka dhënë mbështetjen e drejtorëve në paraqitjen e këtyre kërkesave në grupin punues ndërqeveritar. Bashkangjitur në **aneksin 1** gjeni propozimet e komisionit për menaxhimin e ujit dhe kanalizimit për ndryshim dhe plotësim të projektligjit për ujëra.

▪ **Programi për Zbatimin e Strategjisë së Ngrohjes (PZSN) 2011-2014**

Në diskutimin e pikës së fundit rreth programit për zbatimin e strategjisë së ngrohjes 2011-2014, përfaqësuesit nga MZHE, z. Adnan Preniqi dhe Kemajl Zeqiri bënë prezantimin e kësaj strategjie në

përputhje me qasjen dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, në ngritjen e sektorit të ngrohjes, duke e shndërruar atë në një sektor i cili do të ndikoj në zvogëlimin e përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje, përmes diversifikimit të burimeve të energjisë për ngrohje, rritjes së efikasitetit të pajisjeve për ngrohje si dhe rritjes së performancës termike të stokut të ndërtesave. Pra, përmes Programit të Zbatimit të Strategjisë së Ngrhjes 2011-2014, synohet që politikat dhe masat për përmbushjen e objektivave të sektorit të ngrohjes të adresohen dhe të zhvillohen në projekte konkrete prioritare, e të cilat do të mund të realizohen gjatë kësaj periudhe kohore. Bashkangjitur në **aneksin 2** dhe **aneksin 3** gjeni Programin e Zbatimit të Strategjisë së Ngrhjes 2011-2014, si dhe Strategjinë e Ngrhjes të Republikës së Kosovës 2011-2018.

Fokusi i zyrtarëve të MZHE-së ishte nëse komunat kanë në planet e tyre apo nga takimet me donatorët të ndryshëm ka pasur kërkesë apo është bërë përpjekje për investim në ngrohje komunale në sektorët alternativ i cili do të zvogëlojë përdorimin e energjisë elektrike, apo marrjen e masave për kursim të energjisë nga objektet ekzistuese dhe ato në ndërtim sikurse është renovimi i ndërtesave të banimit dhe jo-banimit, përmirësimi i pjesshëm i mbështjellësit të ndërtesave (mure, kulm, dritare) apo aplikimi i kodeve të reja për ndërtime të reja.

Shumica e përfaqësuesve komunal shprehën interesin e tyre për ndërmarrjen e masave adekuata për kursim të energjisë elektrike sikurse është ndërrimi i kaldajave, dritareve, kulme, mure etj. Sa i përket ngrohjes qendrore u sqarua se disa komuna kanë planifikuar ngrohje qendrore në qytete por këto projekte po shihen si shumë të kushtueshme për komunat. Disa drejtorë shprehën pakënaqësi me bashkëpunimin me ZRRE ku nuk ka dhënë lejen për ndërtimin e impianteve të energjisë në rastin e Komunës së Novobërdës andaj kërkuan një bashkëpunim më të madh nga MZHE.

Konkluzionet:

- Përkrah rekomandimet e dala nga Kryesia e Kolegjiumit për ndryshim të LNP.
- Themelimi i NP Lokale të bëhet me vendim të Kuvendeve Komunale.
- Ligji të mos kufizohet vetëm në themelimin e ndërmarrjeve të mbeturinave dhe ujit por të përfshij edhe sektorët tjerë të shërbimeve publike si ndriçimi i rrugëve, tregu i gjelbër, ngrohje dhe mirëmbajtje të rrugëve.
- Përkrah rekomandimet e Komisionit për menaxhimin e ujit dhe kanalizimit për ndryshim dhe plotësim të projektligjit për ujëra.

